



## **Takimi i parë themelues i këshillit**

Pas përzgjedhjes së anëtarëve në Këshill për zbatimin e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017, Qeveria e Kosovës respektivisht Zyra për Qeverisje të Mirë organizon takimin e parë themelues të këshillit.

Takimi do të mbahet më 15 Tetor 2014, në ora 10:00, në sallën P/38, kati përdhësë, ndërtesa e re e Qeverisë.

Këshilli për zbatimin e strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile 2013 -2017, do të jetë mekanizmi bazë që do të sigurojë zbatimin e strategjisë si dhe vendosjen, zhvillimin dhe forcimin e bashkëpunimit të Qeverisë dhe OSHC-ve në Kosovë. Themelimi i tij është rezultat i drejtpërdret i punës së përbashkët të Qeverisë së Kosovës gjegjësisht Zyrës për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit dhe Platformës CiviKos.